

VENDIM
Nr. 18, datë 22.3.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NDRYSHIMIN E METODOLOGJISË PËR
VENDOSJEN E TARIFAVE**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1, germet “e” dhe “i” dhe të nenit 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin mbi nevojën për ndryshimin e “Metodologjisë për vendosjen e tarifave”, për gatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

1. Prania e katër dokumenteve, përmbajtja e të cilave përsëritet, në vend që ta lehtësojë praktikën që ndiqet e bën më të ndërlikuar atë.

2. Mungesa e përgatitjes dhe e paraqitjes së planeve të biznesit 5-vjeçar vështirëson parashikimin për ecurinë e shoqërive, investimet e nevojshme që duhet të kryejnë ato dhe prioritetet përkatëse për përmirësimin e shërbimit, të cilat ndikojnë në tarifat e shërbimit.

3. Dokumentacioni aktual që duhet paraqitur së bashku me aplikimin për ndryshim tarife ka nevojë për përmirësime e plotësime.

4. Mosparaqitja e aplikimit për ndryshimin e tarifave me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe plotësimi i tij më vonë, duke e tejzgjatur procedurën dhe vendimmarrjen, shtron nevojën që të hiqet afati, data 30 qershor i vitit aktual dhe aplikimi të jetë i lirë për t'u bërë në çdo moment të vitit, me kushtin që dokumentacioni ligjor, teknik dhe ekonomik të jetë i plotë.

5. Duke u nisur nga fakti që pjesa më e madhe e shoqërive janë shumë të dobëta financiarisht, mbulojnë kostot O&M në nivele të ulëta, por nga ana tjetër ka shoqëri që kanë një performancë menaxheriale dhe operative shumë të mirë, të cilat aplikojnë për ndryshimin e tarifave me qëllim akumulimin e të ardhurave për shlyerjen e kredive dhe më tej për të bërë investime në vlera të konsiderueshme, lind nevoja për rishikimin e metodologjisë duke i kategorizuar shoqëritë sipas mbulimit të kostove.

6. Rishikimi i treguesve kryesorë të performancës, të cilët duhet të jenë të matshëm, me qëllim analizën e tyre dhe impaktin që ato do të japin në përcaktimin e tarifës.

7. Nevoja për rishikimin e skemës së procesit të aplikimit, ndryshimi dhe thjeshtimi i saj.

8. Nevoja për përmirësimin dhe unifikimin e terminologjisë të termave të përdorur.

9. Nevoja për rishikimin e nenit mbi pagesën rregullatore.

10. Nevoja për rishikimin e monitorimit të zbatimit të tarifave, metodologjia duhet të përcaktojë në detaje si do të kryhet monitorimi, cilët tregues do të monitorohen sipas prioritetit dhe sanksionet apo penalitetet në rast mosarritjeje.

11. Zbatimi i reformës territoriale që presupozoi edhe riorganizimin e shoqërive UK, bën të domosdoshme ndryshime dhe përshtatje të dokumentacionit shoqërues të aplikimit, kjo kryesisht në dokumentet teknike dhe ekonomike:

- Informacionin teknik dhe ekonomik në tërësi për shoqërinë e riorganizuar;
- Aplikimi i tarifave të diferencuara për zonën ekzistuese dhe ato të reja ka bërë të mundur përpilimin e tabelave ndihmëse për të marrë këtë informacion, gjë e cila duhet të pasqyrohet në metodologjinë e rishikuar.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për ndryshimin e vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39,

datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e doku-mentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI

Fatime Imeraj